



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Përcjellje për kompetencë

Në përgjigje të kërkesës për informacion të z. {...}., administrator i shoqërisë {...}., regjistruar me numër rendor 13 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1786 prot., datë 25.03.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se:

Kërkesa e mësipërme për informacion ka të bëjë me vënien në dispozicion të informacionit mbi aspektet procedurale dhe implementuese të ligjit nr. 52/2023 “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe kontaktet e grupit të punës që ka kontribuar në hartimin e projektligjit të mësipërm. Sjellim në vëmendje se Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është organi qeverisës i sistemit gjyqësor, i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Sa më sipër, kërkimet e z. {...}. dalin jashtë fushës së kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi nuk i përkasin juridiksionit gjyqësor.

Referuar pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, e në kushtet kur iniciativa ligjore për miratimin e ligjit nr. 52/2023 “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë” është ushtruar nga Ministria e Drejtësisë, ju përcjellim për trajtim e verifikim kërkesën për informacion të z. {...}.

Duke iu falenderuar për bashkëpunimin,